



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji E Interpretimit

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë mësimore, 15 leksione dhe 15 seminare
Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti i II. semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i shkencave ” Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”
Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T’u ofrojë studentëve njohuritë e duhura për historinë e interpretimit të konferencës dhe të rolit të interpretit gjatë gjithë historisë; T’i aftësojë studentët në të kuptuarit dhe zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë punës së interpretimit; Të sigurojë një kalim gradual drejt profesionit të interpretit përmes njohurive mbi çështje etike të përcaktuara nga organizatat profesionale të fushës.

Objektivat specifike lëndore:

1. T’u mundësojë studentëve të reflektojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike punën e tyre dhe të kolegëve të kabinës;
2. T’u ofrojë mundësinë të njohin dhe përdorin interpretimin e konferencës si aktivitet të ofrimit të shërbimeve;
3. T’u mundësojë studentëve mënyrën e menaxhimit të stresit dhe të përballjes me auditorin.

Rezultate të pritshme:

- Aftësia për të menaxhuar situata të ndryshme në fushën e përkthimit;
- Aftësia për të kryer me përpikmëri kërkime terminologjike, baza të dhënash, fjalorë të specializuar;
- Aftësia për të njohur normat dhe praktikat e jetës profesionale;
- Aftësia për të negociuar dhe vendosur marrëdhënie profesionale me klientët.